

## RECENSIONET

### **Gjenocidi kulturor? Fillon me shkatërrimin e arkitekturës**

Bevan, Robert. 2023. *Shkatërrimi i kujtesës: Arkitektura në luftë*” *Cuneus: Prishtinë, përkthyer në gjuhën shqipe nga Florina Jerliu.* [Titulli origjinal: *The Destruction of Memory: Architecture at War, 2nd expanded edition,* London: Reaktion Books, 2016]

Përgjatë historisë së njerëzimit luftërat kanë qenë pjesë e pandashme dhe e pandalshme e mbijetesës dhe zhvillimit të saj. Luftërat e përgjakshme janë zhvilluar në shumë fronte dhe trajta, ndërkaq njëra nga format më të përhapura dhe më të kobshme, ishte, dhe mbetet akoma, shkatërrimi i ndërtesave, shtëpive, qyteteve e monumenteve të ndryshme kulturore, historike e fetare. Autori i librit *Shkatërrimi i kujtesës: arkitektura në luftë* arrin, përmes hulumtimi të thellë, të argumentojë se djegia, rrënimi, bombardimi apo çfarëdolloj tjetër shkatërrimi i arkitekturës, nuk është pasojë vetëm e luftës, por në të vërtetë është vet qëllimi thelbësor i atyre që nisin dhe nxisin luftën. Sepse, me shkatërrimin dhe përpjekjen për zhdukjen e artefakteve historike, arkeologjike, monumenteve historike dhe trashëgimisë kulturore në përgjithësi, në esencë synohet zhbërja e kujtesës, identitetit dhe vet ekzistencës së popullit që i krijoi e ndërtoi të gjitha këto. Spektri i objekteve arkitektonike që shqyrtohen në libër është i gjerë dhe i shumëllojshëm, prej atyre religjioze, si xhamitë, kishat, sinagogat e tempujt e ndryshëm deri te ato të karakterit civil si muzetë, bibliotekat, shkollat e ndërtesat e veçanta. Gjithashtu, edhe gama e rasteve që analizohet është tejet e pasur, si në aspektin e shtrirjes hapësinore e gjeografike, ashtu edhe në përfshirjen kohore e historike. Bevan-i argumenton përmes analizave të shumta ndër lidhjen që ka shkatërrimi i ndërtesave me synimin për nënshtrim dhe me qëllimin latent të agresorëve për të rrënuar strukturën e prekshme të kujtesës dhe identitetit së shoqërisë së prekur. E për vlerën, kuptimin dhe simbolikën e të cilave objekte, zakonisht vetëdijeshohemi vetëm pas shkatërrimit dhe ballafaqimit traumatik me humbjen e tyre.

Edhe sot e kësaj dite e kam të freskët rrëfimin e nënës sime, tani e ndjerë, e cila e kishte e përcjellë e tmerruar nga ballkoni i banesës sonë, në pjesën veriore të Mitrovicës, sesi përball ndërtesës sonë, një lagje e tërë e banuar nga shqiptarët që djegur nga forcat paramilitare serbe. Aty gjendeshin disa shtëpi që mbanin edhe pëllumba, të cilët

fatmirësisht kishin shpëtuar duke fluturuar dhe pas një kohe ishin kthyer për disa ditë rresht në rrënojat e atyre shtëpive të djegura, ku çdo gjë tashmë kishte mbetur shkumb e hi. E njëjta i ndodhi edhe xhamisë së vjetër të qytetit, te ura e lumit Ibër, teqeve dhe me shumë objekteve të tjera kulturore e historike. Me këtë rast, siç edhe argumenton bindshëm Bevan-i, shkatërrimi i artefakteve dhe objekteve nuk është ‘dëm kolateral’, por shkatërrim sistematik me qëllim për të krijuar rrethana të një spastrimi kulturor dhe përfundimisht të një harrese të detyruar. Gurët e tullat si pjesë e një trashëgimie materiale të një populli bëhen armiq të atyre që përpiqen të shfarosin atë popull. Bevan- thekson se “nëse gurët themeltarë të identitetit nuk janë më aty, kujtimet fragmentohen dhe zhvendosen; shkatërrimi armiqësor i tyre është amnezi e detyruar me forcë ndaj grupit si grup dhe ndaj pjesëtarëve të tij individual. Larg syve mund të kthehet, njëpërnjë, në larg mendjes...” (fq.29).

Mënyra se si njerëzit kujtojnë të kaluarën gjithashtu pasqyron se si ata e kuptojnë të tashmen, por gjithashtu ndikon në mënyrën se si e ndërtojnë të ardhmen e tyre. Arkitektura e trashëgimia kulturore shërben si pjesë përbërëse e kujtesës kolektive dhe së këndejmi ndihmon për të ruajtur identitetin e një grupi shoqëror. Prandaj bëhen shënjestër e lakmuar në përpjekjen flagrante për të shkatërruar një popull të caktuar. Autori merr shembuj që nga shkatërrimi i Akhenaten-it në Egjiptin e lashtë, pastaj të Kartegjenës, gjuha, kultura dhe feja e së cilës nuk mbijetuan nga shkatërrimi i romakëve. Ai diskuton edhe për qytetet e lashta të kulturave të pasura azteke, qytetërimeve maja dhe inka e deri te periudha e shekullit XX-të me qytetet si Guernica, Dresdeni, Nablusi, Aleppo, Sarajeva, Mostari dhe vendbanime të shumta në Kosovë. Autori e trajton me hollësi rastin e shkatërrimit të urës së Mostarit e ndërtuar në shekullin e XVI, në mbrojtje të UNESCO-s, e cila u rrënuar me 9 Nëntor 1993 pas bombardimeve të njëpasnjëshme të forcave kroate, pa pasur rendësi ushtarake ose paraqitur ndonjë kërcënim sigurie. Fakti që kjo urë simbolizonte bashkëjetesën mes komuniteteve, multikulturalizmin, tolerancën ndër-fetare dhe ishte pjesë e një trashëgimie historike ishte pikërisht arsye pse u be cak i sulmit dhe shkatërrimit të tij.

Në fillim të këtij shekulli u bënë përpjekjet e para për rregullim ligjor dhe kodifikim sipas të drejtës ndërkombëtare të kësaj çështje, kur edhe u miratua Konventa e Hagës e vitit 1907 dhe u plotësua më vonë me atë të vitit 1954 për mbrojtje të pronës kulturore në konflikte të armatosura. Përkundër kësaj, shkatërrimet sistematike të trashëgimisë historike dhe spastrimet kulturore, nuk u parandaluan me legjislacionin ndërkombëtar në fuqi. Këtë pohim e ilustron autori më së miri me rastin e shkatërrimeve të qëllimshme e sistematike nga ana e forcave serbe në Bosnje ku u shkatërruan 3,226 objekte të trashëgimisë historike prej te cilave 1,415 të trashëgimisë islamike, 309 katolike dhe 36 ortodokse. Vetëm në Sarajevë janë shkatërruar 1,386 objekte të trashëgimisë kulturore e ndërtesa historike. Mënyra e egër, pamëshirshme dhe sistematike e zhbërjes se arkitekturës jo-serbe në Bosnje, Kroaci dhe në Kosovë padyshim që ishin pjesë përbërëse e qëllimit të politikës nacionaliste serbe të spastrim etnik dhe gjenocidit. Ngjashëm siç ishin edhe synimet e nazizmit me shkatërrimin e sinagogave gjatë *Kristalnacht*, të trashëgimisë kulturore tibetiane nga ana e Kinës ose të trashëgimisë kulturore e fetare armene nga ana e Turqisë së atëhershme, edhe këto shkatërrime ishin

paralajmërim tmerrues për gjenocid dhe spastrimit kulturor sistematik.

Njëkohësisht autori shpalos shembuj të shumtë kur shkatërrimi bëhet mjet dhe qellim edhe i grupeve terroriste, siç ishte rasti më i spikatur dhe simbolik me shembjen e kullave binjake në New York, duke përfshirë në këtë aspekt edhe bombardimet masive të qyteteve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kështu, bie fjala, vetëm në qytetet gjermane janë hedhur mbi 200.000 tonë bomba. Po ashtu, edhe bombardimet ndaj Dubrovnikut dhe shumë vendeve tjera kanë qenë përpjekje për të ndjell frikë, panik e dëshpërim te popullata si synime strategjike të terrorizmit. Gjithashtu, çështja e shkatërrimit të trashëgimisë bëhet pjesë e propagandës politike, siç pasqyrohet në libër në rastin e raportit në uebfaqen e internetit nga Ministria e Kulturës e Serbisë, e cila akuzon për shkatërrim të kishave e objekteve fetare serbe të cilat, sipas tyre janë kryer nga forcat e NATO-s dhe nga shqiptarët e Kosovës. Por, siç thekson autori, raporti hulumtues i studiuesve nga Harvardi, Andrew Herscher dhe András Riedlmayer i përgënjeshtrojnë bindshëm këto pretendime si të pabaza e manipuluese, në shumë raste. Si shembuj të spikatur jepen shkatërrimi i monumentit historik të Lidhjes së Prizrenit dhe ai i kishës katolike Shën Antoni në Gjakovë, të cilat sipas pretendimeve serbe, ishin sulmuar nga bombat e NATO-s, kur në fakt policia serbe me granat-hedhës në mars të vitit 1999 vet i kishte shkatërruar.

Me njohuri të shkëlqyeshme të kontekstit historik, rrethanave politike e argumente shteruese Bevan-i bën ndërlidhjen mes shkatërrimit të shtëpive, trashëgimisë kulturore e arkitektonike, në njërin anë, dhe të popujve, në anën tjetër, duke e shtjelluar atë ndërlidhje edhe në rastet e pushtimeve, revolucioneve, ndarjeve etnike e sektare si në rastet në Palestine, Tibet, Qipro, Bejrut, Belfast etj. Po ashtu, ai e shpejgon edhe procesin e rindërtimit dhe përkujtimit e si pjesë e keqpërdorimeve dhe mashtrimeve me dëshmitë e rikrijuar të ndërtesave dhe artefakteve të cilat bëhen vazhdimësi e politikës me mjete tjera dhe i shërbejnë krijimit të realitetit të ri në terren, sikurse edhe përforcimit të pushteteve ekzistuese. Ristrukturimi i qyteteve si pjesë e revolucioneve politike është po ashtu pjesë e ekzaminimit në këtë libër, që synon revizionimin e historisë, p.sh. rasti i Moskës nën sundimin e Stalinit, Pekinit gjatë Mao's si dhe i Bukureshtit gjatë regjimit të Çausheikut. Siç edhe thekson ai, “ndërtesat nuk janë politike, por politizohen nga mënyra si ndërtohen, vlerësohen dhe shkatërrohen” (fq.23).

Kritika e tij vazhdon edhe me neglizhencën dhe pakujdesinë e shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare ndaj kërcënimeve dhe zhbërjes së trashëgimisë kulturore mijëvjeçare edhe gjurmëve arkeologjike, siç është rasti me ato në Irak, Afganistan, Siri e gjetiu. Prandaj, kërkon me ngulm që të respektohet zbatimi i plotë të konventave e drejtës ndërkombëtare për mbrojtje të pronës materiale e kulturore si dhe të ndërmerren masa më të ashpra e gjykime ndaj shkatërruesve dhe urdhërdhënësve si kriminelë lufte për këto krime. Gjykimi i udhëheqësve serbë të Bosnjës, Ratko Mladiq dhe Radovan Karagjiq, me akuza edhe për shkatërrim të vendeve të shenjta, sikurse edhe të gjeneralit kroat Slobodan Praljak për shkatërrimin e urës së Mostarit, apo të ushtarakëve serbë për bombardimin e Dubrovnikut, janë shpresëdhënëse në këtë aspekt. Në këto kohëra tejet shqetësuese e me pamje televizive të shkatërrimeve si në Gaza, Ukrainë apo gjetiu, duhet dhënë të drejtë autorit se: “shkatërrimi është shpesh rezultat i imperativit politik,

dhe jo thjesht i domosdoshmërisë ushtarake” (fq. 262).

Argumenti thelbësor të cilin e ndërton Bevan-i përgjatë tërë librit është se arkitektura shërben si përkujtues i vazhdueshëm i kujtesës sociale, kulturës dhe të kaluarës së një komuniteti, prandaj edhe bëhet cak i sulmeve, rrënimeve e rimodelimeve të shumta gjatë konflikteve, luftërave e revolucioneve dhe shkatërrimi i saj shkakton trauma të thella. Kjo është një ndërlidhje e pashkëputur mes shkatërrimit të kulturës materiale dhe dëmtimit e nënshtrimit të krijuesve të tij. Prandaj, libri me të drejtë kërkon vëmendjen e ndërgjegjësimit tonë. Libri lexohet edhe si një apel që dukuri të tilla shkatërrimi nuk duhet të kalojnë pa kundërshtimin dhe këmbënguljen tonë që t’ i dënojmë dhe mundësisht t’ i parandalojmë.

Libri është shkruar me informata të hollësishme dhe të dhëna të bollshme për rastet e përshkruara dhe për kontekstin e përgjithshëm të palëve në konflikt. I shkruar shkruar me një gjuhë të pasur e kuptueshme, libri është një burim pothuajse i detyrueshëm për të gjithë studiuesit e interesuarit e fushës, si të arkitekturës, ashtu edhe të historisë dhe shkencave shoqërore në përgjithësi. Me mjeshtri stilistike e objektivitet shkencor, ky libër arrin të vë në pah ndërlidhjen e ndërveprimin midis arkitekturës, kujtesës dhe identitetit, duke sjelle dëshmi dhe shembuj të panumërt të rasteve, në kohëra, hapësira dhe rrethana të ndryshme, të rrezikut që i kanoset trashëgimisë kulturore dhe pasojat e shkatërrimit të saj.

Në fund, mbetet të përgëzohen për punën përkthyesja edhe botuesi që sollën këtë libër kaq të çmuar e të nevojshëm për lexuesin shqipfolës, duke e nxitur ndërgjegjësimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe për restaurimin e atyre të shkatërruara gjatë dhe pas luftës, e të cilat në Kosovë nuk janë fare të pakta.

**Bekim Baliqi**

Departamenti i Shkencave Politike

Fakulteti Filozofik

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Email: [bekim.baliqi@uni-pr.edu](mailto:bekim.baliqi@uni-pr.edu)